



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 191, Datë 30.08.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“AEE” SH.P.K, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “PLUG” ME FUQI TË INSTALUAR
2MW**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1, gërma “a”, të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.08.2018 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AEE” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AEE” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Shoqëria “AEE” sh.p.k., me shkresën nr.194 Prot, datë 09.08.2018, protokolluar në ERE me nr. 549 Prot, datë 09.08.2018, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Plug”, me fuqi të instaluar 2 MW.

Aplikimi i shoqërisë “AEE” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.4.1; pika 4.4.2; pika 4.4.3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 4.4.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 4.4.5 gërmat “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me :

- Miratimin e OST ose OSSH-s për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*, ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë e procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AEE” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Plug” me fuqi të instaluar 2MW.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI